



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ nr.101/2023

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit, NTP “A. C., me seli në F., sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve, “SCRL Partners”,sh.p.k., me seli në P., S...., kundër të paditurës, Dogana e Kosovës, (DK), me bazë juridike, vlerësim i mallit doganor, duke vendosur sipas kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, K. DH. SH. II. nr. 141/22, të datës 20.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 19 Tetor 2023, merr;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar nga paditësi, NTP “A. C.”, me seli në F., kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II., nr. 141/22 të datës 20.01.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë në Prishtinë, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e datës 07.02.2020, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A. nr. 2026/17 i datës 17.09.2020, vërtetohet.

Paditësi për mes përfaqësuesit të lartë cekur, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, më të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Komerciale për shkak të; aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet si i pa bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II. nr. 141/22 të datës 20.01.2023, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative –divizioni fiskal A. nr. 2026/17, datë 17.09.2020, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve në kërkesë dhe akteve tjera të lëndës, gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga aktet në lëndë rezulton se, me aktvendimin e organit të paditur, të DK-së, nr.01.3.2.2./705, A.H., të datës, 17.10.2017, refuzohet si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e vendimit nr. 03.1.1-2017-157, të dt. 03.10.2017, të Sektorit të Kontrollës pas Importues, si e pa bazuar, sipas të cilit duke vepruar sipas kërkesës së ZBD P., për verifikim të rabateve të deklaruara nga eksportuesi, “H.-S.”, conform nenit 82, dhe 233 të KDA, dhe nenin 83 të LPA, e ka obliguar paditësin me obligime doganore në emër të TVSH-së, në shumë prej 9, 225.32€.

Kundër këtij aktvendimi paditësi ushtron padi në procedurë gjyqësore të konflikt administrativ, me kërkesëpadi që i njëjti të anulohet si jo i drejtë dhe ligjor. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave në seancë kryesore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, konform nenit 81G, të Ligjit nr. 04/L-102 me datë 17.09.2020 merr aktgjykimin e ankimuar, A. nr. 2701/18, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si jo të bazuar, ndërsa e len në fuqi aktvendimin e organit të paditur, nr. 01.3.2.2/705, të dt. 03.10.2017.

Në arsyetim ndër të tjera theksohet se, nga vendimi i organit të paditur dhe provat e administruara në seancë gjyqësore rezulton se, nga organi i paditur në procedurë administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga është vërtetuar që paditësi nuk ka bërë deklarin e saktë në kuptim të vlerës së mallit lëndor sipas DUD-ave kontestues me rastin e zhdoganimit. Nga dokumentacioni i analizuar gjatë vizitës tek paditësi është vërejtur se rabatin e deklaruar e ka mbështetur në “Protokol”, për lirim mbi mallin e caktuar, mirëpo nga faturat është vërejtë se rabati nuk përfshinë vetëm mallrat e cekura në „protocol”, por të gjithë faturën, nga rezulton se paditësi përfiton rabat më shumë se sa është e lejuar me dokumantacion. Se gjat kontrollit janë gjetur prova materiale të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi nuk e ka deklaruar saktë rabatin e dhënë nga eksportuesi, H.-S., sepse në bazë të kontratës dhe aneks kontratës të lidhur me eksportuesin, i ishte lejuar rabat 5%, si dhe 2%, super rabat. Nga provat e administruara gjykata konstaton gjendjen e njëjtë po ashtu se paditësi nuk posedon dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar rabatin se i është lejuar ashtu si e paraqet në faturat përcjellëse të mallit lëndor prej 20%-35%, rabat. Prandaj vlerëson se e paditura këtë gjendje faktike në bazë të cilës ka rezultuar me obligime doganore shtesë, me të drejtë dhe baza ligjore si në kuptim të nenitn 82 të KDA e ka konstatuar në bazë të dëshmimeve, si kontrata për kushtet gjenerale, kontrata, dhe ankes kontrata e lidhur me eksportuesin H.-S. dhe “Protokoli” nr. 1”, dhe në bazë të tyre janë bërë ndryshimet në DUD-at, kontestues të vitit 2017. Gjykata e shkallës së parë pretendimet e paditësit i refuzon si jo të bazuara me që i njëjti nuk arrin të ofroj prova të argumentuara që do të dëshmonin të kundërtën, lidhur me harmonizimin e vlerës së rabatit të dhënë nga eksportuesi, prandaj konstaton se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e obligon me detyrime shtesë doganore në emër të TVSH duke iu referuar nenit, 82.3, të KDA, nr. 03/L-109.

Gjykata Komerciale duke vendosur në procedurë ankimore kundër aktgjykimit të shkallës së parë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, K.DH.SH.II. nr. 141/22 të datës 20.01.2023, e refuzon të pa pabazuar ankesën e paditësit, ndërsa qëndrimin juridik të shkallës së parë e pranon në tërësi si të rregullt dhe ligjor, me që nuk gjen fakte dhe arsye që i njëjti të jetë i përfshirë me shkelje procedurale, me mos vërtetim të gjendjes faktike, apo me zbatim të gabuar të dispozitave të KDA ashtu si pretendon, sepse në organin e paditur, në gjykatën e shkallës së parë dhe as në procedurë ankimore, paditësi nuk paraqet prova në bazë të cilave do të provoheshin pretendimet e ngritura.

Tutje vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje, andaj vlerëson njëjtë si gjykata e shkallës së parë se paditësi nuk ka prezentuar dëshmi të bazuara që argumetojnë se ka përfituar rabatin e cekur si në fatura përcjellëse të mallit. Kolegji i kësaj gjykate në bazë të dokumenteve të bashkangjitura si Aneks kontrata nr.1, e dt. 27.02.2017, konstaton gjendjen e njëjtë që nga eksportuesi paditësit i është lejuar 5% rabat dhe 2% super rabat, ndërsa në faturat përcjellëse të mallit për DUD-at cekur si në aktvendimin e sektorit të kontrollit pas importues vlera e rabatit është 20%-30% , ndërsa sa i përket dokumentit “Protokol”, gjykata e shkallës së dytë konstaton se ky dokument nuk është pjesë e kontratës kryesore dhe aneksit të saj ,por lëshohet për vetëm për ngarkesë, andaj nga DK , me të drejtë është konstatuar se rabati i deklaruar në faturë nuk përfshinë vetëm produktet e këtij, “protokoli” por përfshinë të gjithë faturën. Pretendimet e paditësit, se ka paraqitur dëshmit e nevojshme përcjellëse për zhdoganimin e mallit lëndor, të cilat kan qen në rregull ligjrisht lidhur me rabatin e paraqitur, i refuzon si jo të bazuara dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse i njëjti nuk ka rritur të dëshmoj për mes kontratës ose anekseve të saj, që rabati në faturë është i njëjtë me rabatin në kontratë shitblerje të mallit lëndor kontestues, sipas DUD-ave kontestues.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme pas ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë me refuzimin si të pabazuara të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, meqë aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me aplikim të gabuar të drejtës materiale si e thekson paditësi në kërkesën e tij.

Sipas nenit 82 të Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, (KDA), nr. 03/L-109, është përcaktuar se Dogana mundet, zyrtarisht ose me kërkesën e deklaruesit të rishqyrton deklaratën pas lirimit të mallit. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e personit që ka deklaruar mallin, ose të çdo personi, drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij, ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana po ashtu mund të kontrollojë edhe mallërat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. Pa rënë ndesh me nenin 219.3, kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana në përputhje me dispozitat në fuqi,do të ndër marrë masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar , duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion.

Bazuar në dispozitat e cekura të nenit 82 të KDA, pretendimet e paditësit të cekura si më lartë në kërkesë, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson të pa bazuara dhe jo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale por edhe i gjykatës së shkallës së parë janë të qartë në dispozitiv dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme në baza ligjore për faktet

vendimtare, prandaj nuk rezulton se janë të përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes fatike e cila ka sjellë aplikimin e gabuar të dispozitave materiale si pretendon paditësi. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare si në kuptim të nenit 204 të LPK-së, dhe nga arsyetimi i aktgjykimit provohet se me të drejtë i ka pranur si të drejta dhe të ligjshme arsyet dhe faktet relevante vendimtare të vërtetuara për të gjitha pretendimet e ngritura në seancë të shqyrtimit nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykatat e instancave më të ulëta dhe organi i paditur si në vendimin e tij përfundimtar në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejtë kanë aplikuar dispozitat materiale të KDA-së, andaj theksimet e tjera në kërkesë, se nga dokumentet e prezentuara nga subjekti të cilat janë lëshuar nga eksportuesi, lehtë vërtetohet se mallrat e importuar kanë patur rabat andaj nga aspekti ligjor janë të vlefshme dhe është dashtë të pranohen nga DK-së, DUD-at e prezentuar me vlerë realisht të paguar sipas faturës e cila në tërësi përputhet me vlerën e eksportuese ashtu si janë prezentuar sipas dokumenteve e tjera, se gjykytat e instancave më të ulëta nuk i kanë vlerësuar pretendimet e palës paditëse për sa i përket harmonizimit të vlerës sipas urdhërpagesës bankare dhe faturave të mallit kontestues dhe jo kontestues, në drejtim të vlerës së tij sipas rabatit etj., kolegji i Gjykatës Supreme po ashtu i vlerëson si jo të qëndrueshme, sepse të njëjtat pretendime janë shqyrtuar nga instancat e gjykatave më të ulëta si dhe organi i paditur ashtu si u theksua si më lartë, nga rezulton që në mënyrë të plotë është vërtetuar që rabati i deklaruar nga paditësi sipas faturave prëcjellëse të mallit sipas DUD-ave kontestues, nuk ishte në përqindje siq ishte përcaktuar me kontratë dhe aneks kontratë të lidhur me eksportuesin, duke e paraqitur me përqindje më të lartë, të konstatuar si në vendimin e sekorit të kontrollit pas importues të paditurit, të vërtetuar edhe në procedurë gjyqore si në aktgjykimet e instancave më të ulëta, po ashtu në faturë ishte i përfshirë i gjithë malli, e jo vetëm i produkteve të cilat parashihen sipas, "Protokollit".

Mbi këtë gjendje të fakteve rezulton se, gjykatat e instancave më të ulëta dhe organi administrativ përfundimtar i paditur, në këtë çështje juridike administrative drejtë kanë vërtetuar faktet vendimtare të qështjes lëndore dhe drejtë kanë aplikuar dispozitat ligjore të KDA-së, dhe LKA-së, andaj nuk është cënuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit.

Nga sa u tha lartë dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1 i Ligjit për konfliktet administrative, është vendosur si në dispozitivë të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ. nr.101/2023, me datë 19 Tetor 2023

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani